

Shoqeria shnderruese "ALBA COSMETIC 2014" Sh.p.k  
PROJEKTI I SHNDERRIMIT



Ne mbeshtetje te Ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Q.K.R", Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ne R.SH." Asambleja e Pergjithshme e shoqerise "ALBA COSMETIC 2014" sh.p.k me NIPT L42224502H ka diskutuar lidhur me operacionin e shnderimit te kesaj shoqerie ne nje shoqeri aksionere pa oferte publike, pra duke kaluar te gjitha te drejtat dhe detyrimet, te shoqerise "ALBA COSMETIC 2014" sh.p.k. ne shoqerine e shnderruar "ALBA COSMETIC INTERNATIONAL" sha. dhe eshte caktuar administratori, Z. Adi Mehmeti, te hartoje projektin e shnderrimit.

1 - Lenda e projektit.

- 1- Te dhena mbi shoqerine pjesemarrrese ne operacionin e shnderrimit.
- 2- Qellimi dhe kushtet e shnderrimit.
- 3- Caktimin dhe vleresimin e aktivitetit dhe te pasivitetit qe eshte parashikuar t'i kaloje shoqerise se shnderruar ("ALBA COSMETIC 2014 Sh.p.k)
- 4- Menytrat e kalimit te pjeseve te kapitalit, si dhe daten pas se ciles ky operacion do te konsiderohet, ne aspektin e kontabilitetit si te kryera.
- 5- Raportin e kembimit te drejtave dhe detyrimeve (pa shperbim) ne shoqeri.
- 6- Te tjera


2 -Te dhena mbi shoqerite.

Shoqerite qe merr pjese ne operacionin e shnderrimit eshte shoqeria "ALBA COSMETIC 2014" sh.p.k. e cila eshte themeluar me date 22/10/2014 me adrese ne Lagjen Porto Romano, Rruga Velipoja, Durres.

Kapitali themeltar i shoqerise ka qene 100.000 leke dhe zoterohet nga ortaku i vetem Adi Mehmeti.

Aktualisht kapitali eshte 374.000.000, nga keto 178.098.377 jane ne para dhe 195.901.623 jane ne natyre. Per kontributet ne natyre eshte bere vlersimi i tyre nga eksperiti kontabel Luan Muca me 11/06/2018, raport i cile eshte bashkangjitur dokumentacionit perkates.

Ortaku Adi Mehmeti zoteron 100 kuota e barabarte me 100% te kapitalit.



*2- Qellimi dhe kushtet e bashkimit*

a - Rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve te shoqerise, larmia e sherbimeve dhe produkteve qe ofron si ne fushen e estetikes, kozmetikes dhe parfumerise, produkte te higjenes, produkte ushqimore te bukurise, te tratimit te lekures si dhe detergjente te llojeve te ndryshme, transport mallrash brenda dhe jashte vendit, prodhim dhe ambalazhim i bombulave te gazit njeperdorimshe te gramaturave te ndryshme etj., Te gjitha keto e bejne te domosdoshme rritjen e kapaciteteve administruese si edhe kontrolluese te saj. Pikerisht per kete arsye shfaqet si strukture me e pershtatshme forma e shoqerse aksionere me nje nivel administrimi e cila ben nje shperndarje te pergjegjegjesise dhe njkohesisht edhe nje kontroll me te sakte mbi veprimtarine e shoqerise e cila do te ushtrohet nga keshilli i administrimit.

b - Kushtet e shnderrimit jane qe te kalohen ne teresine e tyre aktivet dhe pasivet ne shoqerine e shnderruar.

*3-Caktimin dhe vleresimin e aktivitetit dhe pasivitetit qe eshte parashikuar te kaloje ne shoqerine e shnderruar.*


Per caktimin dhe vleresimin e aktivitetit dhe pasivitetit qe eshte parashikuar kaloje ne shoqerine e shnderruar, do te hartohen llogarit e konsoliduara te cilat do te vertetohen nga eksperte kontabel te autorizuar, si dhe do te miratohen nga asambleja e pergjithshme e kesaj shoqerie. Ne kete vertetim do te merret parasysh vlera kontabel e hyrjes se asetve dhe borxheve ne pronesi te shoqerise.

Ky shnderrim nuk sjell asnje pasoje mbi te drejtat e detyrimit, qe shoqeria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

*4- Menyrat e kalimit te pjeseve te kapitalit, si dhe daten pas se ciles ky operacion do te konsiderohet, ne aspektin e kontabilitetit si te kryera.*

Te gjitha te drejtat, detyrimit, aktivet dhe pasivet e shoqerise "ALBA COSMETIC 2014" shpk do te transferohen ne teresine e tyre ne "ALBA COSMETIC INTERNATIONAL" sha.

Ky operacion nuk do te kete asnje pasoje mbi te drejtat e detyrimit, qe shoqeria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.



Data pas se ciles operacioni i shnderrimit kesaj shoqerie, ne aspektin e kontabilitetit do te konsiderohet data e regjistrimit te shnderrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe pasqyrimi i saj ne Regjistrin Tregtar dhe veprimet ne kontabilitet pas kesaj date do te kryhen nga shoqeria e shnderruar "ALBA COSMETIC INTERNACIONALE" sha, nga data e pasqyrimin te regjistrin tregtar dhe ne vazhdim.

#### *5-Raporti I kembimit te drejtave ne shoqeri.*

Raporti i kembimit te te drejtave ne shoqeri do te ruhet i njejte. Shoqeria do te kete kapital prej 374.000.000 leke. Kapitali do te ndahet ne 100 aksione me vlere nominale 3.740.000 Leke.

Aksioneri Adi Mehmeti do te zoteroje 100 aksione e barabarte me 100% te kapitalit

#### *6-Te tjera.*

Gjate hartimit te ketij raporti nuk jane hasur veshtiresi te vecanta ne lidhje me vleresimin si edhe ky shnderrim nuk do te kete asnje efekt ne lidhje me punemarresit te cilet do te vazhdojne te punojne sipas kontratave te lidhura me to duk u ndryshuar si pale vetem punedhenesi i cili do te jete shoqeria "ALBA COSMETIC INTERNACIONALE" sha. Te gjitha te drejtat dhe detyrimete qe punemaresit gezojne ne baze te ketyre kontratave dhe legjislacionit te punes mbeten te pandryshuara.

Pergatitja e gjithc dokumentacionit te operacionit perfundimtar te shnderrimit te shoqerise "ALBA COSMETIC 2014" sh.p.k. ne shoqerine "ALBA COSMETIC INTERNATIONAL" sha do te realizohet sipas kerkesave te Ligjit nr. 9901.14.04.2008 , "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare ne R.SH".

*Durres me 13/07/2020*

Administratori i shoqerise "ALBA COSMETIC 2014" sh.p.k.

Adi Mehmeti

Adi Mehmeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS  
NOTER INES V. ALEKSI

DATE 13/07/2020  
NR REP 1881

V2020011920087782999



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 13.07.2020, para meje Notere INES V. ALEKSI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.11, ALEKSANDER GOGA, u paraqit personalisht:

**DEKLARUES/IT:**

Shoqëria ALBA COSMETIC 2014, NIUS L42224502H, Administratori Adi Mehmeti, atësia Gani, amësia Hadixhe, shtetas Shqiptar, lindur në Delvinë, Delvinë dhe banues në TIRANE, me adresë 1052 Yzberish Rr.Teodor Keko ap.1/1 shk.A, lindur më 04/12/1993, gjendja civile "i martuar", madhor. me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 029860874 dhe nr. personal J31204033Q.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "PROJEKTI I SHENDERRIMIT i Shoqërisë "Alba Cosmetic 2014" shpk , bashkëlidhur.

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenin 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



NOTERE  
INES V. ALEKSI